



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Nr. 538/ Prot.

Tiranë më, 13 02.2026

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr. 538 prot., datë 29.01.2026.

QENDRA “RES PUBLICA”

Z.Dorian Matlija

Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa nr.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Referuar kërkesës suaj për informacion, e protokolluar pranë institucionit me nr. 538 prot., datë 30.01.2026, e cila është në vijimësi të korrespondencës me nr. 196/25 prot., datë 25.12.2025, për të cilën është kthyer përgjigje me shkresën nr. 151 prot., datë 13.01.2026 nga institucioni.

Ju informojmë si më poshtë:

DSHQ, është person juridik në varësi të Kryeministrit dhe vepron në bazë të Ligjit nr. 7582 datë 13.07.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, i ndryshuar, V.K.M-së nr. 34, datë 07/01/1999, “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e Personaliteteve të Larta Shtetërore”, i ndryshuar dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1058, datë 16/07/2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave pasuri të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave” për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare” i ndryshuar.

Bazuar në kërkesën tuaj për informacion dhe duke u mbështetur te VKM nr. 34, datë 07.01.1999, e ndryshuar, që përcakton rregullat për administrimin dhe përdorimin e pasurive shtetërore, procedurat e mirëmbajtjes së godinave shtetërore ndërmerren për të garantuar ruajtjen funksionale dhe fizike të objekteve në administrim, të cilat kanë status të veçantë si pasuri shtetërore në përdorim të institucioneve të larta shtetërore.

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare gjatë periudhës 01.01.2025-22.12.2025, ka realizuar procedurat e nevojshme periodike të mirëmbajtjes së godinave në administrim, nëpërmjet strukturave dhe personelit teknik të institucionit, duke shfrytëzuar bazën materiale të disponuar ndër vite.

Ndërhyrjet e mirëmbajtjes kanë karakter periodik dhe kryhen në bazë të nevojave konkrete të evidentuara rast pas rasti nga strukturat teknike përgjegjëse. Në përputhje me kuadrin ligjor në

fuqi për administrimin e pasurive shtetërore, përfshirë Ligjin nr. 7582, datë 13.07.1992, “Për Ndërmarrjet Shtetërore”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 34, datë 07.01.1999, i ndryshuar, ndërhyrjet e mirëmbajtjes realizohen mbi bazën e gjendjes faktike të objekteve dhe nevojave funksionale që paraqiten gjatë vitit ushtrimor.

Në vijim të trajtimit të kërkesës suaj, ju informojmë se zëri shpenzime materiale të përdorura për periudhën e kërkuar është në vlerën 6,731,334 lekë.

Këto ndërhyrje janë realizuar për të siguruar standardet e duhura të sigurisë, funksionalitetit dhe prezantimit dinjitoz të objekteve në përputhje me qëllimet për të cilat ato janë vënë në dispozicion, si dhe për të përmbushur detyrimet ligjore për mirëadministrimin dhe ruajtjen e aseteve shtetërore, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Në përfundim, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare konfirmon se janë respektuar të gjitha procedurat ligjore në trajtimin e kërkesës suaj dhe mbetet e angazhuar për të siguruar transparencë institucionale.

Duke ju falenderuar,

**KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTOR ADMINISTRATIV**

